

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7128
E mërkurë, 28 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Parlamenti Evropian
miraton direktivën që
mbron gazetarët kundër
padive SLAPP¹ FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HARADINAJ: KOSOVA ËSHTË NË PRAG TË HUMBJES SË MBËSHTETJES SË PARTNERËVE STRATEGJIKË, POSAÇËRISHT SHBA-së FAQE 4-5



Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se vendi ynë është në prag të humbjes së mbështetjes së partnerëve strategjikë, posaçërisht

ShBA-së. Ai ka theksuar se në një situatë të tillë është obligim forcimi i alternativës politike që i jep fund 'qeverisë anti-shtet të Albin Kurtit'. "Kosova është përcaktuar në rrugën e


vet euroatlantike dhe partneriteti me aleatët, veçmas me Amerikën, është i pandryshueshëm, pavarësisht kush mund të jetë në qeveri sot apo nesër", ka thënë Haradinaj

**BISLIMI: SERBIA
PO E PENGON
RRUGËN DREJT
NORMALIZIMIT
TË PLOTË TË
MARRËDHËNIEVE
DHE NJOHJES
RECIPROKE** F. 5




**KRAHU I
BINAK DINËS
DHE 88
VJETËT E
BACË ADEM
DEMAÇIT** F. 6

Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



AKTUALE



**KAMBERI: S'KA PAQE NË BALLKAN PA
NORMALIZIM TË MARRËDHËNIEVE
KOSOVË - SERBI** F. 3

**ÇFARË NËNKUPTON PËR SUEDINË
HYRJA NË NATO?** F. 5

**GUVERNATORI I BQK-SË: NË BRUKSEL
DISKUTUAM PËR MODALITETET E
FINANCIMIT NGA SERBIA** F. 4

EKONOMI

**DËSHTIMET ME BORXHIN SHETËROR
TË KOSOVËS 2021-2023** F. 8

Shkruan:
Avdullah HOTI



**KONTRATAT ME NEGOCIM NË MMPHI,
OPOZITA ME AKUZA PËR MINISTRIN
LIBURN ALIU** F. 8



SPORT



**KOSOVA, FITUESE E TURNEUT
'TURKISH WOMEN'S CUP'** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bashkëpunëtorët thonë se s'po gjejnë vend për ceremoninë e lamtumirës për Navalnyn

MOSKË, 27 SHKURT - Bashkëpunëtorët e politikanit të ndjerë opozitar, Aleksei Navalny, thanë se nuk po mund të gjejnë një vend në kryeqytetin rus për të organizuar një ceremoni publike të lamtumirës për kritikun e Kremlinit, pasi nëna e tij tha se është shantazhuar nga zyrtarët që të mbajë të fshehtë një ceremoni të lamtumirës për të birin. "Ne kemi thirrur shumicën e agjencive private dhe shtetërore të funeraleve, entitetet komerciale dhe ato që organizojnë ceremoni të lamtumirës. Disa thanë se i kanë të zëna vendet, të tjerët refuzuan të flisnin pasi dëgjonin emrin e Navalnyt", tha zëdhënësja Kyra Yarmysh përmes një postimi në "X". "Në një vend na thanë direkt që janë

urdhëruar të mos bashkëpunojnë me ne", shtoi ajo një ditë pasi publikoi një postim ku thuhej se ekipi i Navalnyt po kërkonte një vend për të organizuar një ceremoni publike të lamtumirës të premtën.

Familjarët e Navalnyt ende nuk kanë konfirmuar detaje për ceremoninë e lamtumirës dhe funeralin për kritikun e Kremlinit.

Më 26 shkurt, në kanalën Baza në Telegram, duke cituar burime të paidentifikuara, u tha se në varrezën Borisovskoje në Moskë punëtorët kishin nisur përgatitjet për varrosjen e Navalnyt gjatë natës, duke shtuar se data preliminare për këtë ceremoni ishte caktuar 29 shkurti.

Disa kanale në Telegram kanë



përmendur vende të mundshme ku Navalny mund të varroset dhe që të gjitha varrezat e përmendura ishin në Moskë.

Trupi i Navalnyt iu dorëzua nënës së tij, Lyudmila Navalnaya,

më 24 shkurt, më shumë se një javë pasi ai vdiq në rrethana të dyshimta në një burg në Arktik. Ende nuk është bërë publike shkaku i vdekjes së 47-vjeçarit.

Para se t'ia dorëzonin trupin e të

birin, nëna e tij tha se autoritetet kishin vendosur kushte se ku, kur dhe si do të varroset Navalny, duke shtuar se autoritetet dëshironin që ceremonia të ishte e fshehtë.

Qindra rusë janë arrestuar gjatë homazheve për Navalnyn në mbarë Rusinë.

Familjarët e Navalnyt, bashkëpunëtorët e tij dhe zyrtarët perëndimorë kanë fajësuar presidentin rus Vladimir Putin për vdekjen e tij. Zyrtarët rusë kanë hedhur poshtë këto akuza.

Navalny vdiq derisa po vuante një dënim prej 19 vjetësh burgim nën akuza që përfshinin ekstremizëm. Ai, mbështetësit e tij, zyrtarët perëndimorë dhe organizatat për të drejtat e njeriut i kishin cilësuar akuzat si të motivuara politikisht.

Macroni: Aleatët janë pajtuar për ta furnizuar Ukrainën me raketa

PARIS, 27 SHKURT - Udhëheqësit evropianë janë pajtuar të krijojnë një koalicion për ta furnizuar Ukrainën me raketa me rreze të mesme dhe të gjatë veprimi dhe bomba, për t'i mbështetur përpjekjet e Kievit për ta luftuar pushtimin e nisur nga Rusia. Kështu tha presidenti i Francës, Emmanuel Macron, pas një samiti të liderëve të kontinentit të mbajtur në Paris.

Kancelari gjerman Olaf Scholz, presidenti polak Andrzej Duda dhe udhëheqësit nga shtetet e Baltikut po ashtu morën pjesë në samit që zgjati deri të hënën mbrëmë. Shtetet e Bashkuara u përfaqësuan në samit me diplomatin kryesor për Evropë, James O'Brien, ndërkaq në samit mori pjesë edhe sekretari i Jashtëm i Britanisë, David Cameron. "Ne, po ashtu, kemi vendosur t'i japim një shtysë të re koalicionit të mbrojtjes ajrore, gjë për të cilën ka bërë thirrje presidenti ukrainas



[Volodymyr Zelensky], dhe ta krijojmë koalicionin e nëntë këtë mbrëmje, një koalicion për raketa dhe bomba me rreze të mesme dhe të gjatë veprimi, me të cilat mund të kryhen sulme të thella", tha Macroni gjatë një konference

për media të mbajtur pas takimit.

Zelensky, që iu adresua samitit përmes videolidhjes, u bëri thirrje udhëheqësve evropianë që të sigurohen që presidenti rus Vladimir Putin "nuk mund t'i shkatërrojë arritjet tona dhe

të mos mund ta zgjerojë agresionin e tij në shtete të tjera".

Ukraina varet shumë nga armët e avancuara dhe furnizimet me municion nga aleatët perëndimorë, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara, për t'iu bërë ballë sulmeve intensive nga forcat ruse, të cilat nisin pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Trupat ukrainase, që janë më të pakta në numër dhe me mungesë armatimesh, së fundi u detyruan të tërhiqen nga disa pozicione mbrojtëse në lindje, teksa një paketë e ndihmës ushtarake e ShBA-së në vlerë prej 61 miliardë dollarësh mbetet e bllokuar në Dhomën e Përfaqësuesve të kontrolluar nga republikanët. Evropa do ta ndihmojë Ukrainën "të marrë iniciativën dhe të veprojë së bashku në një kohë kur ka pasiguri në ShBA sa i përket ndihmës", tha Macroni, duke shtuar se në mesin e udhëheqësve që

morën pjesë në samit kishte "konsensus të gjerë për të bërë më shumë dhe në mënyrë më të shpejtë".

Ai tha se "asnjë konsensus" nuk ekziston për dërgimin e trupave tokësore perëndimore në Ukrainë, por shtoi se "asgjë nuk duhet të përjashtohet për ta arritur objektivin tonë. Rusia nuk mund ta fitojë luftën", tha Macroni.

Ndaras presidenti polak Duda tha për gazetaret pas takimit se "nuk kishte entuziazëm" në mesin e pjesëmarrësve lidhur me mundësinë e dërgimit të trupave perëndimore në Ukrainë.

Pjesëmarrësit në takim thanë se ka rritje të mbështetjes nga shtetet evropiane, përfshirë Francën, për një nismë të Çekisë për të blerë municione dhe predha jashtë Bashkimit Evropian dhe për t'i dërguar në Ukrainë.

Kryeministri Mark Rutte tha se Holanda ka vullnet që të ofrojë mbi 100 milionë euro për këtë qëllim.

Bideni shpreson për një pauzë të luftimeve në Gazë gjatë Ramazanit

WASHINGTON, 27 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se Izraeli do të jetë i gatshëm ta ndalë luftën e tij kundër Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian gjatë Muajit të

Ramazanit, nëse arrihet një marrëveshje për lirin e disa pengjeve që mbahen nga radikalët palestinezë.

Negociatorët nga ShBA-ja, Egjipti dhe Katari po punojnë për kornizën e një marrëveshjeje, sipas së cilës, Hamasi do të lironte dhjetëra

pengje që mban në këmbim të lirit të të burgosurve palestinezë dhe ndaljen e luftimeve për gjashtë javë. Gjatë kësaj pauze të përkohshme, negociatat do të vazhdonin për lirin e pengjeve të mbetura. Ende nuk ka ndonjë reagim

nga Izraeli lidhur me deklaratat e Bidenit.

Ramazani nis më 10 mars dhe shihet si një afat jozyrtar për një marrëveshje armëpushimi. Në këtë muaj besimtarët myslimanë në mbarë botën agjërojnë nga agimi deri në muzg.



Haradinaj: Kosova është në prag të humbjes së mbështetjes së partnerëve strategjikë, posaçërisht ShBA-së

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se vendi ynë është në prag të humbjes së mbështetjes së partnerëve strategjikë, posaçërisht ShBA-së. Ai ka theksuar se në një situatë të tillë është obligim forcimi i alternativës politike që i jep fund 'qeverisë anti-shtet të Albin Kurtit'. "Kosova është përcaktuar në rrugën e vet euroatlantike dhe partneriteti me aleatët, veçmas me Amerikën, është i pandryshueshëm, pavarësisht kush mund të jetë në qeveri sot apo nesër", ka thënë Haradinaj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PEJË, 27 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova sot është në udhëkryq, në një fazë vendimtare politike. Sipas tij, orientimi që ka marrë udhëheqja politike po i rrezikon krejt të arriturat e deritashme të Kosovës. "Sot jemi në prag të humbjes së mbështetjes së partnerëve strategjikë, posaçërisht të partneritetit me Shtetet e Bashkuara, që mund të ketë pasoja katastrofike për vendin. Në një situatë të tillë është obligim ynë forcimi i alternativës politike që i jep fund 'qeverisë anti-shtet të Albin Kurtit'. Kryesia e Aleancës, në qytetin ku edhe është krijuar, në Pejë, me histori mijëra vjeçare e kurrë e nënshtruar, por gjithmonë në ballë, sikundër edhe në luftën e fundit të luftës për liri e për

Atdhe, e fillon ciklin e diskutimeve për veprimet konkrete të mobilizimit të saj dhe të shtrirjes e të forcimit të Bashkimit, i cili tashmë e ka krijuar bërthamën e vet me Nismën Social-Demokrate, Klubin e Intelektualëve E-30 dhe me Listën Konservatore", ka thënë Haradinaj gjatë një takimi në Pejë me strukturat e partisë. Ai ka thënë se ky bashkim politik do të rritet dhe nuk do të ndalet derisa ta krijojnë masën kritike që i jep fund kësaj logjike antikombëtare qeverisë dhe, sipas tij, aspak nuk është e rastësishme pse nga Peja. "Kosova është përcaktuar në rrugën e vet euroatlantike dhe partneriteti me aleatët, veçmas me Amerikën, është i pandryshueshëm, pavarësisht kush mund të jetë në qeveri sot apo nesër. Dhe për të ndodhur kjo, para nesh dalin disa detyra urgjente. E para ta rikthejmë dinjitetin e njeriut që po shkelet



pamëshirshëm nga kjo kastë qeverisëse, demokracinë në vend, ta ndalim trendin shqetësues të emigrimit dhe Kosovën ta përshtatim për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane dhe anëtare e NATO-s", ka thënë ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Para tre ditësh i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Qeveria e Kosovës, me mospërbushjen e kërkesës amerikane për çështjen e dinarit serb, nuk po e trajton Uashingtonin si partner. "Nuk dua të flas se cilat janë të gjitha pasojat, por mendoj se deklaratat tona publike kanë treguar qartë

se ku po shkojnë raportet tona diplomatike dhe politike. Ne jemi shumë të shqetësuar sepse Qeveria e Kosovës nuk po na trajton si partner. Ata nuk punojnë me ne për stabilitetin rajonal dhe minojnë dialogun, proces për të cilin ShBA-ja është e përkushtuar plotësisht. Mendoj se ambasadori [amerikan në Kosovë, Jeffrey] Hovenier e ka thënë më së miri: kjo ndërlikon kapacitetin tonë për ta ndihmuar Kosovën që të integrohet në komunitetin transatlantik", ka thënë Escobari në një intervistë dhënë për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe. Escobari ka shtuar se mospërfillja e kërkesave amerikane

vështirëson punën e ShBA-së që ta ndihmojë Kosovën për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës, NATO-n dhe Bashkimin Evropian. "Sa herë që ne flasim për Kosovën me partnerët e tjerë, veçmas me ata që nuk e njohin atë, ata e shohin se Kosova nuk përmbush obligimet e saj të dialogut që është nën ombrellën e BE-së, që përfaqëson të gjithë BE-në. Prandaj, na bëhet e vështirë që t'i mbrojmë në çfarëdo mënyre argumentet e Kosovës, përfshirë anëtarësimin në BE dhe NATO, në Këshillin e Evropës dhe në shumë organizata të tjera", ka deklaruar Escobari.

Kamberi: S'ka paqe në Ballkan pa normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 27 SHKURT - Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka deklaruar se mund të ketë paqe në Ballkan, porse ka shtuar se që kjo të ndodhë duhet të ketë normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Këtë deklaratë Kamberi e bëri pas takimit që pati me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, i cili po mban takime për ta formuar qeverinë. "Kur shikoni shembuj të shumtë që kanë ndodhur në mbarë botën të pajtimit të kombeve që ishin në mosmarrëveshje apo edhe në luftëra, pajtimi është i mundur. Nëse ishte i mundur në Afrikën e Jugut, sigurisht që



është i mundur në Ballkan. Çka është ajo që ndoshta e ka ndihmuar procesin e pajtimit në

Afrikën e Jugut është fakti që të gjithë ata njerëz që ishin të përfshirë në shkelje të rënda të

të drejtave të njeriut në një proces të udhëhequr nga kryepeshkopi Desmonduto e pranuan fajin e tyre, ndoshta nuk janë gjykuar, por ka qenë e mjaftueshme që ata publikisht ta pranojnë dhe për këtë të flasin publikisht", tha ai. Sipas Kamberit, dialogu për normalizim duhet t'i ndryshojë rrënjësisht marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Çfarë ndodh këtu, dialogu për normalizim duhet t'i ndryshojë rrënjësisht marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, edhe stabilitetin e tërë Ballkanit Perëndimor. A besoj se mund të ketë ndonjë pajtim pa

normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë? Të them të drejtën, jo. Kam qenë skeptik qysh në fillim për projektin e Ballkanit të Hapur, që parashihej t'i përfshinte gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor, në të cilin u përfshinë vetëm tri, dhe në të cilat një nga anëtarët, Republika e Serbisë, po përpiquej të ndërtonte marrëdhënie vëllazërore me trupin e popullit shqiptar, ndërsa publikisht përmes medieve, nga zyrtarët më të lartë të shtetit, në njëfarë mënyre dërgonte mesazhe fyese në kurriz të pjesës tjetër të atij populli të Kosovës", u shpreh ai.

Komisioni për Legjislacion draftoi Kodin e sjelljes për deputetët e Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 27 SHKURT - Grupi punues i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kryesuar nga Besnik Tahiri, pas më shumë se një vit pune, diskutime, analiza, vizita, përfundoi draftimin e Kodit të

sjelljes për deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ky kod do ta adresojë sjelljen e deputetëve, gjuhën joparlamentare, veshjet zyrtare dhe veprimet e tjera të ndaluara. Një sjellje me etikë është detyrim i secilit deputet për të promovuar vlera të larta

qytetare. Me këtë rast, anëtarët e grupit punues të Komisionit për Legjislacion falënderuan anëtarët e komisionit homolog nga Shqipëria për bashkëpunimin përmbajtësor në këtë proces, si dhe Institutin Demokrat Kombëtar (NDI) për mbështetjen e vazhdueshme për draftimin e këtij dokumenti.





Bislimi: Serbia po e pengon rrugën drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve dhe njohjes reciproke

Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryenegociator në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka thënë të martën se Serbia po vazhdon të refuzojë që ta zbatojë marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve, edhe një vit pas arritjes së saj. Përtej kësaj, ai ka theksuar se Serbia ka shkelur tetë nene të Marrëveshjes Bazike, preambulën e saj dhe nene të Aneksit implementues. Bislimi ka thënë se marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i saj Implementues duhet të zbatohen sa më parë

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e ka akuzuar Serbinë se po vazhdon të refuzojë që ta zbatojë marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve një vit pas arritjes së saj. "Ende pa zbatim të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit Implementues të Ohrit. Kur do të duhej të ishim në rrugën e drejtë të zbatimit të plotë dhe pa kushte të Marrëveshjes së Brukselit, shënojmë një vit nga dita kur u dakordua ajo, dhe Serbia ende refuzon ta nënshkruajë, rrjedhimisht dhe ta zbatojë marrëveshjen. Përkundrazi, përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare jemi përballur me shkeljet e Serbisë, eskalimet e saj në terren, refuzimin verbal dhe zyrtar të marrëveshjes dhe qasjes së vazhdueshme destruktive", ka shkruar Bislimi në "Facebook". Bislimi, që është kryenegociator i Kosovës në dialogun me Serbinë, ka thënë se më 27 shkurt në

Bruksel, më 18 mars në Ohër, më 14 shtator në Bruksel, më 26 tetor në Bruksel, më 8 shkurt në Nju-Jork, plot pesë herë u ofrua dhe publikisht nënshkrimi i marrëveshjes, por u refuzua. "Përtej kësaj, Serbia ka shkelur tetë nene të Marrëveshjes Bazike, preambulën e saj dhe nene të Aneksit implementues", ka thënë Bislimi. Ai ka theksuar se pas pajtimit të Brukselit dhe Ohrit, Serbia ka shantazhuar e kërcënuar serbët e Kosovës të mos marrin pjesë në zgjedhjet lokale të prillit, sulmuar një muaj më pas institucionet e Kosovës, KFOR-in dhe gazetarët. "Rrëmbyen brenda territorit tonë tre zyrtarë policorë, sulmuar veriun e shtetit tonë më 24 shtator në aktin e agresionit të Banjskës, afrian trupat ushtarake përreth kufirit tonë dhe si kërcënim i qartë dhe i hapur deklaruan se nuk do ta njohin sovranitetin e integritetin territorial të Republikës së Kosovës, si dhe zyrtarisht me shkrim konfirmuan refuzimin e Marrëveshjes së Brukselit

përmes letrës së kryeministres Brnabiq në dhjetor. Në vetëm një vit, të gjitha këto akte dhe sjellje dëshmuar se Serbia po e pengon fuqishëm avancimin në rrugën drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve dhe njohjes reciproke", ka deklaruar Bislimi. Ai ka shtuar se Kosova nga ana e saj qëndron konstruktive dhe e angazhuar në këtë rrugëtim, në zbatimin e plotë, të drejtë e pa kushte të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit Implementues, përmes një plani të sekuencimit të balancuar mes palëve. "Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i saj Implementues duhet të zbatohen sa më parë. Rajoni ka nevojë për zhvillim dhe prosperitet, harmoni dhe marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha shtetet e rajonit", është shprehur Bislimi. Marrëveshja prej 11 nenesh e arritur në Bruksel, ndër të tjera, parashih edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i

zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Nga 11 pikat e Marrëveshjes Bazike deri më tani palët kanë zbatuar vetëm ato që kanë të bëjnë me personat e zhdukur dhe njohjen e targave të makinave. Megjithatë, zyrtarë të lartë të Kosovës dhe Serbisë shprehën vazhdimisht qëndrime që lanë të kuptohet se nuk janë të gatshëm t'i përmbahen marrëveshjes. Kurti këmbëngul në nënshkrimin e marrëveshjes pasi, siç konsideron ai, kjo do të ishte garanci që edhe Serbia do t'i përmbushte obligimet e saj. Në mes të janarit të këtij viti ai tha se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe "nuk është prioritet" për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe se nuk duhet veçuar. Në tetor të vitit të kaluar diplomatët perëndimorë i paraqitën Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për formimin e Asociacionit, i cili u hartua nga BE-ja dhe të cilin palët thanë se e pranojnë. Vuçiqi, në anën tjetër, përsërit vazhdimisht se Serbia nuk do të pranojë kurrë që Kosova të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizim të raporteve ka nisur më 2011. Procesi ndërmjetësohet nga BE-ja dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara.

Muhaxhiri: Marrëveshja mund të zbatohet vetëm me presion

Sociologu dhe analisti Artan Muhaxhiri thotë se marrëveshja e vitit të kaluar u arrit "me shumë investime dhe vështirësi" dhe se u besua se palët do të jenë "mjaft të zgjuara" për të përfituar prej saj. "Megjithatë, realiteti ynë i ashpër politik jovizionar e ka transformuar atë në diçka krejt tjetër - një shenjë të mosgatishmërisë për të ecur përpara dhe simbol të ndërlikimeve ekstreme të dialogut", ka thënë ai për "Radion Evropa e Lirë". Muhaxhiri ka theksuar se marrëveshja mund të zbatohet në kapacitetin e saj të plotë vetëm "me presion të madh dhe të vazhdueshëm" nga ShBA-ja dhe BE-ja. Sipas tij, udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë zgjodhën ta "bllokojnë" marrëveshjen përmes qëndrimeve populiste, porse në fund do të duhet të pranojnë gjithçka që refuzojnë. "Marrëveshja është përgatitur, hartuar, planifikuar, vlerësuar për shumë muaj. Versioni përfundimtar i saj synon ta strukturojë më qartë dhe ta pozicionojë në mënyrë institucionale pozitive e pakicës serbe në Kosovë, pasi të jetë rënë dakord për një formë dhe model kreativ të njohjes nga Serbia", ka pohuar Muhaxhiri.

Çfarë nënkupton për Suedinë hyrja në NATO?

BRUKSEL, 27 SHKURT - Aplikimi i Suedisë për anëtarësim në NATO, që u dorëzua pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 2022, e tejkaloi pengesën e fundit, pasi që Hungaria votoi për ratifikimin e pranimin të Stokholmit të hënën, më 26 shkurt. Pranimi në aleancën ushtarake perëndimore përbën ndryshim të madh si për mbrojtjen e Suedisë, por edhe për balancën gjeopolitike në rajon.

Pse Suedia vendosi t'i bashkohej NATO-s?

Në fund të luftërave napoleonike në fillim të shekullit 19, Suedia miratoi neutralitetin si politikë zyrtare. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, politika e neutralitetit u zëvendësua me atë të mosangazhimit ushtarak. Përderisa Suedia ka dërguar forca në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, shteti nuk ka zhvilluar luftë për më shumë se 200 vjet.

Konflikti i fundit që ishte zhvilluar ishte lufta suedeze-norvegjeze më 1814.

Pavarësisht prej neutralitetit, Suedia ka ndjekur një politikë të jashtme aktive, ka qenë shtet me nivel të lartë të respektimit të drejtave të njeriut dhe donatorja më e madhe për kokë banore, dhe për këtë shpesh shteti është quajtur "superfuqi humanitar". Por, përderisa ka qëndruar jashtë NATO-s, Suedia ka krijuar raporte të ngushta me aleancën dhe më 1994 iu bashkua Programit të Partneritetit për Paqe dhe më pas më 1997 edhe Këshillit të Partneritetit Euroatlantik.

Megjithatë, shumica e suedezeve për një kohë të gjatë kishin kundërshtuar anëtarësimin e plotë dhe kjo temë është parë si tabu nga Socialdemokratët, që është partia më e madhe politike në Suedi.

Ish-ministri i Mbrojtjes nga Socialdemokratët, Peter Hultqvist, madje kishte deklaruar



vjeshtën e vitit 2021 se ai mund të "garantonte" se kurrë nuk do të merre pjesë në procesin e anëtarësimin në NATO.

Vetëm disa muaj më vonë, pushtimi rus i Ukrainës, që nisi më 2022, çoi në një ndryshim dramatik të mendimit të opinionit publik, por edhe të partive politike.

Një shumicë e gjerë e Parlamentit suedez votoi për të aplikuar për anëtarësim dhe shteti dorëzoi aplikimin - së bashku me Finlandën - në maj të vitit 2022.

Çfarë sjell Suedia në NATO?

Për një kohë të gjatë politika suedeze thoshte se shteti kishte nevojë për një ushtri të fuqishme për ta mbrojtur neutralitetin e Suedisë. Por, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, shteti uli shpenzimet e mbrojtjes, duke kthyer përqendrimin e ushtrisë drejt operacioneve paqeruajtëse në mbarë botën.

Më 1990 shpenzimet e mbrojtjes

përbënin 2.6 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm, ndërkaj kjo përqindje ra në 1.2 më 2020, sipas qeverisë.

Shpenzimet për mbrojtje nisën të rriten sërish pas aneksimit të paligjshëm të Gadishullit ukrainas të Krimesë nga Rusia më 2014.

Në mars të vitit 2022, pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Suedia njoftoi se sërish do t'i rriste shpenzimet, duke thënë se kishte për qëllim të shpenzonte 2 për qind të Bruto Prodhimit të Brendshëm "sa më shpejt që të jetë e mundur".

Në fund të vitit 2023 Qeveria e Suedisë tha se shpenzimet e ushtrisë do ta tejkalonin synimin prej 2-përqindësh gjatë vitit 2024. Ushtria suedeze ka afër 50 000 ushtarë dhe gjysma e tyre janë rezervistë.

Forcat Ajrore suedeze kanë më shumë se 90 avionë luftarakë të llojit JAS 19 Gripen - që prodhohen brenda vendit - dhe po ashtu Marina suedeze e Baltikut përfshin disa luftanije dhe nëndetëse.

Kryeministri suedez Ulf Kristersson tha në janar se shteti i tij veçse është i gatshëm të kontribuojë me trupa në forcat e NATO-s në Letoni.

Anëtarësimi i Suedisë dhe Finlandës në NATO, po ashtu, nënkupton se Deti Baltik rrethohet nga shtetet aleate dhe disa analistë po e quajnë liqë të NATO-s. "Është pjesa e fundit e mozaikut në hartën e NATO-s në Evropën Veriore që tani po vendoset në vend", tha për AFP-në, Robert Dalsjo, analist në Agjencinë suedeze të Hulumtimeve të Mbrojtjes (FOI).

Cilat janë implikimet për mbrojtjen e Suedisë?

Si shtet anëtar, llogaritjet ushtarake të një shteti ndryshojnë në disa aspekte kyçe.

"Suedia për një kohë të gjatë ka punuar duke u nisur nga supozimi: 'Ne i bëjmë vetë detyrat'", tha Jan Henningson, hulumtues në FOI.

"Tani, kjo ndryshon", shtoi ai, duke

shpjeguar se mbrojtja e tyre tani duhet të bëhet brenda aleancës. "Tani ne duhet të mësohemi të veprojmë brenda ekipit. Ne duhet të përshtatemi me faktin që ne nuk po përgatitemi që ta mbrojmë vetëm territorin suedez, por territorin", theksoi Dalsjo.

Për Suedinë, anëtarësimi në aleancë përmbys mendimin tradicional të raporteve të fuqisë në një konflikt potencial. "Tradicionalisht, ne kemi menduar se jemi shtet i vogël dhe kushdo që na sulmon ne është shumë më i madh", tha Henningson.

Por, kur bëhet fjalë për ekonominë dhe demografinë, "NATO-ja është shumë më e madhe se Rusia", sipas Henningsonit. "Do të jetë një forcë mjaft mbresëlënëse me shpresën që fuqia e kombinuar e 32 shteteve, nga Turqia në jug, e deri në Svallbard", tha shefi i ushtrisë suedeze, Jonny Lindfors, për gazetën "Dagens Nyheter" në dhjetor. Ai shtoi se mendon se forca e shtuar zvogëlon rrezikun e shpërthimit të një konflikti. (AFP / Përgatiti: Mimoza Sadiku)

Guvernatori i BQK-së: Në Bruksel diskutuam për modalitetet e financimit nga Serbia

Prishtinë, 27 shkurt - Në Bruksel ka përfunduar takimi i përbashkët mes ekspertëve financiarë të Kosovës dhe të Serbisë nën ndërmjetësimin e emisarit evropian për dialogun, Mirosllav Lajçak, lidhur me përdorimin e dinarit serb në Kosovë.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se gjatë takimit janë diskutuar modalitetet teknike se si mund të vazhdojë financimi nga Serbia përmes kanaleve ligjore dhe transparente në llogari bankare të përfituesve në



euro, bazuar në propozim e BQK-së dërguar te Banka Popullore e Serbisë". "Nuk ka asgjë tjetër dhe as nuk kemi pranuar diskutime të tjera", ka

thënë Ismaili, duke shtuar se rregullorja është në fuqi dhe nuk ndryshohet. "Zbatimi i saj nuk vihet në diskutim. Mundësi ligjore ka për

transfer legal. Nëse gjithmonë Serbia ka gatishmëri t'i shfrytëzojë ato", është shprehur ai.

Një rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), që ka hyrë në fuqi më 1 shkurt, parasheh euron si valutën e vetme për kryerjen e pagesave me para të gatshme në Kosovë, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb. Sipas BE-së, ky vendim ka shkaktuar probleme praktike për komunitetin serb në Kosovë, i cili ka përdorur dinarin serb dhe me këtë valutë ka marrë ndihmë nga Serbia.

Para takimit të përbashkët, Lajçaku gjatë 27 shkurtit është takuar me delegacionin serb, i udhëhequr nga kryenegociatori Petar Petković. Më pas, emisari evropian është takuar me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili.

Kosova nuk ka dashur që në takimet në Bruksel të dërgojë nivel politik sepse beson se çështja e rregullores së BQK-së për pagesat me para të gatshme nuk duhet të jetë temë e dialogut për normalizimin e raporteve me Serbinë.

Krahu i Binak Dinës dhe 88 vjetët e bacë Adem Demaçit

Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Llogorja në Stara Gradishkë: Të burgosurit politikë shqiptarë që kanë bërë burgun në Kroaci kanë qenë kryesisht në Goli Otok, Lepogllavë dhe Stara Gradishkë, ndërsa në bazë të vlerësimit janë dërguar në izolim/veçim në njërin nga Qendrat e Paraburgimit anekënd Kroacisë. Ishte edhe një burg për femra në Sllavonska Pozhegë por se aty, për sa kam informata, nuk kishte të dënuara politike nga Kosova. Ne që ishim në këto burgje mendonim se të burgosurit politikë shqiptarë në burgjet e Serbisë kishin kushte më të vështira, por pas informatave që i morëm, burgjet në Kroaci sa iu përket kushteve fizike ishin më të rëndat në ish-Jugosllavi. Goli Otoku kishte një histori të keqe që nga koha e Informbirosë ku të burgosurit politikë, kundërshtarë të Titos, në mesin e të cilëve kishte shumë shqiptarë, kalonin nëpër një fer të vërtetë, të paparë dhe të paimaginueshëm për një shtet evropian. Pastaj, burgju i Goli Otoku u bë burg për të mitur dhe trajtimi i tyre ishte i mirë sikur edhe kushtet fizike, përfshirë këtu mundësinë e shfrytëzimit të detit sipas një orari të caktuar/rutine. Për të keq mbahet mend burgju i Idrizovës, i Zenicës dhe i Spuzhit, kurse burgju në Foçë qysh atëherë i plotësonte të gjitha kushtet që kërkohen nga vendet demokratike, të njohura për respektim të të drejtave të personave të privuar nga liria. Burgju në Lepogllavë ku vuanin dënimin deri me 20 vjet burg (ishte dënimi maksimal për atë kohë) ishte si një burg hetues i madh; qelitë ishin të gjata 2.5 metra dhe të gjëra 1.5 metra. Brenda kësaj hapësire ishin tre krevate, nuk kishte ujë dhe as tualet/veçitore. Uji ruhej në shishe, kurse nevoja fiziologjike kryhej në kibëll/oturak i cili në mëngjes zbrazej në një tualet të përbashkët. Të burgosurit ishin të kategorizuar në kategori të A, B dhe C. C-ja ishte kategori dënuese. Thuaja në më shumë se 90 % të dënimit kam qenë në këtë kategori. Në Lepogllavë uji ishte i mirë sikur që edhe ajri ishte i pastër sepse gjendej në Zaborje, rajon i pyllëzuar i Kroacisë dhe jo shumë larg kufirit me Austrinë dhe Hungarinë. Ndërkaq, në Burgllogorin në Stara Gradishkë situata ishte ndryshe, dukshëm më e keqe se në Lepogllavë. Aty ishin dhomat me 36 - 40 të burgosur, pjesa dërrmuese e të cilëve pinin duhan. Nuk kishte fare ujë brenda e as tualet/veçitore. Nevojat fiziologjike të burgosurit i kryenin në një bure të madhe metali/me aso që bartej uji më parë në Kosovë nga lumi apo ndonjë burim, e mbuluar me një kapak prej dërrasave që nuk e mbyllte si duhej këtë bure, prandaj në dhomë kundërmonte era e urinës/shurrës dhe m...t. Sidomos kjo ishte e theksuar gjatë verës kur temperaturat ishin të larta. Dera e

dhomës, pas mbylljes/numërimit në ora 20:00, mbyllej dhe nuk hapej deri në orën 6:00 të mëngjesit kur shkonim të pastroheshim në tualetin e përbashkët. Gjatë kësaj kohe dera hapej vetëm kur ndonjë i burgosur ishte keq me shëndet apo kur ndodhte ndonjë konflikt midis të burgosurve. Batanijet dhe dyshekët ishin thuaja ato që kishin mbetur pas përfundimit të luftës së dytë botërore, të padinjitetshme për të mbuluar edhe kafshët e lëre më njeriun. Llogori në Stara Gradishkë ishte ndërtuar në një vend moçalik, ishte afër lumit, ajri ishte shumë i ndotur dhe i papastër. Uji ishte i ndotur me llaq dhe kur pastrohesh trupit të mbulohej me ujë të kuq (si gjaku) për shkak të llaqit. Në këto kushte ka vuajtur dënimin Bacë Adem Demaçi i cili asnjëherë nuk u ankua për këto kushte dhe nuk kërkoi që t'i përmirësohen ato. Këpucët i kishte 20 vjet të vjetra ndërsa dimrit për shkak të ngricave, këpucët ngriheshin dhe duhej një kohë për t'i mbathur. Dënimin e tretë prej 15 vjetësh Baca Adem e ka vuajtur në Burgllogorin e Stara Gradishkës, në kushte të tmershme dhe në mesin e kriminelëve më të rrezikshëm për faktin se në këtë burg i dërgonin të dënuarit, siç i kishin thënë edhe Bacës drejtuesit e Burgut: "për t'i lënë kockat aty...". Ne që shkuam më vonë ishim në një situatë më të mirë sepse qëndronim shkurt aty (disa vite) sikur që edhe kushtet ishin përmirësuar pak. Unë kam qenë një vit (1989 - 1990) me Bacën Adem, në një krah/pavijon të përbashkët të Llogorit në Stara Gradishkë prandaj i di kushtet në të cilat ishte Baca. Ndërsa, kishte shumë të burgosur politikë shqiptarë dhe kroatë që kishin ndejtur edhe më gjatë me Bacën e që dëshmojnë për pathyeshmërinë e Bacës edhe në këto kushte dhe refuzimin e çdo trajtimi, si çmimi i shklejes së parimeve nga ana e Bacës. Ka të mjerë, qëllimkëqij, të poshtër që kanë deklaruar haptas se Baca Adem Demaçi nuk ka qenë fare në burg por se ka qëndruar në hotel "Moska" në Beograd, në pushimore të ndryshme në bregdet dhe në vende malore, i shoqëruar me femra, kushte këto që nuk i ka pasur as Pablo Eskobari në burgun që e ka ndërtuar për veten e tij në Kolumbi pas marrëveshjes me qeverinë e Kolumbisë. Këto "informata" për Bacën kryesisht kanë dalë nga shqipfolësit, rrogëtarë të Titos, Rankoviqit dhe Sllobodan Millosheviqit. Këto "informata", pas daljes nga burgju i Bacës kanë dalë nga një grup i strukturuar jugosllav dhe proserb në LDK që, për mision kanë pasur shembjen e personalitetit të Bacës dhe të burgosurve politikë shqiptarë të cilët i konsideronin se mund t'ua rrezikojnë pushtetin që ata e mbanin nën urdhërat e Serbisë. Këta edhe e cilësuan Bacën Adem si marksist, leninist,



enverist dhe komunist ndonëse Baca ishte një nacionalist - kombëtar në kuptimin më pozitiv të fjalës. Mbetjet e UDB-së jugosllave dhe serbe si Jeton Qurroi dhe Cuf Guxhovi madje, nga pozitat e tyre jugosllave dhe proserbe e vënin nën dyshim programin politik të Bacës Adem duke e cilësuar si program i drejtuar kah lindja (Rusia) se nga përcaktimi kombëtar. Vetëm sa e vërtetuan thënieën se: "një herë i poshtër, gjithëherë i poshtër...".

Binak Dinaj dhe të burgosurit e tjerë në Stara Gradishkë: Çdo i burgosur politikë në Kroaci e konsideronte si mision të papërfunduar nëse gjatë vuajtjes së dënimit nuk takohet me Bacën Adem Demaçi. Në Burgllogorin e Stara Gradishkës kishte shumë të burgosur politikë shqiptarë në mesin e të cilëve ishin: Binak Dinaj, Fehmi Lladrovci, Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti, Hafir Shala, Tahir Hani, Asllan - Luan Reshit, Bejtullah Ademi, Idriz Hysenaj, Haki Gashi, Besim Baraliu, Basri Ibrahim, Hysen Shurdhani, Adem Salihaj, Riza Demaj, Xhabir Morina, Ruzhdi Shkodra, Halit Krasniqi, Hamdi Hajdini, Rrahim Rama, Sejfullah Foniqi, Pajazit Jashari, Bedri Deliu, Ilmi Momqilla, Zaim Beqiri, Zenel Baqaj, Ajet Duli dhe të tjerë emri i të cilëve nuk më kujtohet apo kanë qenë në kohën kur unë nuk isha në Stara Gradishkë. Të gjithë kishin qëndrim të fortë dhe nuk u luhatën asnjëherë nga përcaktimi i tyre politik dhe kombëtar. Të gjithë kishin respekt të jashtëzakonshëm për Bacën të cilin e kishin pikënisje dhe pikësynim për arritje të qëllimeve politike dhe kombëtare. Kur procesi i shpartallimit të ish-Jugosllavisë kishte nisur me pavarësimin e Sllovenisë dhe të Kroacisë, ishte e qartë se të burgosurit politikë shqiptarë në Kroaci, ose do të lironen ose të transferohen në Serbi. Autoritetet kroate kërkuan që të burgosurit shqiptarë të bëjnë lutje për lirim, thjesht një lutje formale por, me sa e di unë, asnjë i burgosur politikë shqiptarë nuk e ka bërë një lutje të tillë. Pastaj autoritetet kroate vet e kishin përpiluar lutjen dhe nga shqiptarët kërkohet vatem ta nënshkruajnë por, si në rastin e parë, asnjë i burgosur politikë shqiptarë nuk e vuri nënshkrimin në atë lutje. Disa muaj para lirim, Baca Adem e mbajti një takim me të burgosurit shqiptarë duke

kërkuar mendimin e çdonjërit për kohën e kaluar në burg dhe planet për të ardhmën. Ishte interesant fakti se thuaja të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë u deklaruan se pas përfundimit të burgut do ta vazhdojnë aktivitetin politik dhe kombëtar pasi ishim në gjysmë të rrugës drejt caktit të synuar. Fehmi Lladrovci shkonte përtej saj, thoshte se vetëm me armë mund të çlirohemi. Lufta dhe rënia e tij heroike e dëshmon se nuk i kishte vetëm fjalë por se e kishte bindje dhe veprim të domosdoshëm.

Baca Adem pas daljes nga burgju (viti 1990) mbajti kontakte të rregullta me shumicën e ish të burgosurve politikë që u liruan nga burgjet e Kroacisë në një periudhë 3-5 muaj pasi u lirua Baca. Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti dhe unë ishim më së shpeshti me Bacën, thuja se çdo ditë përmes takimeve dhe vizitave nëpër tërë Kosovën si dhe në Maqedoni. Baca i kishte raporte shumë të afërta me Binak Dinaj, i burgosur në Stara Gradishkë dhe shpesh e vizitonim në shtëpinë e Nakut në Raushiq që i përngjante një kazermë ushtarake. Si nga forma ashtu edhe nga veprimtaria që zhvillohej. Si shumica e shokëve, Binak Dinaj u angazhua në radhët e së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës që nga ditët e para. Në betejën e dytë në fshatin Loxhë midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër Armatës së Jugosllavisë dhe Policisë së Serbisë, në mesmuajin e gushtit të vitit 1998, Binak Dinaj, me një grup ushtarësh të UÇK-së, në një luftë krejtësisht të pabarabartë u plagos rëndë duke e humbur dorën nga një goditje me një predhë. Edhe në atë gjendje, pa e humbur fare vetëdijen, Binak Dinaj rezistoi dhe pasi dora i kishte mbetur varur me një pjesë të lëkurës, Binaku, me dorën e shëndosh e shkëput dorën e goditur nga predha. Realisht, Binak Dinaj, e them jo vetëm figurativisht e humbi krahn që ia pamundësoi të fluturonte drejt betejave dhe fitoreve tjera por ua mundësoi të tjerëve ta vazhdojnë fluturimin drejt fitores dhe drejt lirisë. Për fat të mirë, Naku e priti edhe fitoren, edhe lirinë. U detyrua të shkojë në Gjermani për mjekim meqë këtu nuk kishte as kushte e as vëmendjen e duhur. Të papërgjegjshmit e pushtetit aktual nuk bënë asgjë as për sigurimin e protezave për ata që e nderuan Kombin dhe vendin duke vënë dhe lënë peng edhe gjymtyrët e trupit

Në mesin e tyre ishte edhe shoku ynë i mirë dhe i urtë, Binak Dinaj që e la krahn në betejën e Loxhës pa kërkuar asgjë për këtë sakrificë në kohën kur dezertorët e Betejës së Loxhës u shpallën heronj. Çfarë mbrapshtësie dhe poshtërsie, nga ata që e bënë sikur edhe nga ata që e pranuan këtë!

E them me përgjegjësinë më të madhe se Baca Adem Demaçi ishte personi më i persekutuar, që nga burgosja e parë, dalja nga burgju i tretë e deri sa kaloi në amshim, nga vet shqiptarët apo ata që flisnin shqip dhe mendonin serbisht. Politikisht iu mbyllën të gjitha mundësitë, materialisht varej nga shokët (deri vonë) kurse kombëtarisht nuk mbeti kush pa e sulmuar, këta të Vidovdanit, shkollës së Kumrovcit dhe të konvertuarit alkemistë brenda natës, nga të qenit rrogëtarë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe të Serbisë, tash në "demokratë" të LDK-së. Askush nuk e donte të gjallë, të gjithë e donin të mos ishte gjallë. Kur kaloi në amshim ceremoninë e varrimit, krahasuar me ceremoninë që ua bënë komunistët e LDK-së liderit të tyre, ishin thuaja anarkike, pa asnjë organizim dhe ishte shpërfillje e një realiteti që ndryshoi historinë e re të shqiptarëve. Sa nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore kujdesi i shtetit ishte thuaja i papërfillshëm, frikësisht turpërues. I mbetën vetëm një grup shokësh që udhëtuan me Bacën që nga llogori i Stara Gradishkës e deri sa kaloi në amshim. Një grup shokësh që edhe sot mundohet të ecë rrugës së Bacës Adem, qoftë edhe përmes kujtimeve. Që mban kontakte thuaja të rregullta e që takohen me Bacën sidomos në dy data; në ditën kur lindë dhe në ditën kur kaloi në amshim. Dje, Baca Adem Demaçi, po të ishte gjallë do t'i kishte 88 vjet, në aspektin statistikor konsiderohet shifër e përfillshme, në aspektin e krijimit të veprës konsiderohet si periudhë e pamatshme. Në rreshtim të respektimit të veprës së papërsëritshme të Bacës Adem Demaçi ishim disa shokë që kishim mundësi që fizikisht të jemi aty duke përfaqësuar edhe shokët që fizikisht nuk kishin mundësi të ishin aty. Ishte Nuhi Ahmeti, Basri Ibrahim, Haki Gashi, Elmi Zeka dhe Binak Dinaj. Ne përfaqësuar edhe Idrizin, Besim Baraliun, Tahir Hanin, dr. Balin, Limanin, Luanin, Bejtën, Avdullahun dhe Elmi Reçicën. Vizitua edhe familjen e Bacës dhe u respektua nga zonja Arbërie Demaçi. Përveç respektit për Bacën Adem që është edhe kusht i domosdoshëm për ne si njerëz, si komb dhe si shtet, respektua edhe krahn e Nakut, i lënë peng për lirinë edhe të atyre që nuk e meritojnë, një pjesë e së cilëve sot janë në pushtet. Dikush e viziton Bacën si refleks shpirtëror dhe domosdoshmëri, të tjerët sepse janë të veshur dhe mbuluar me pafytyrësinë e tyre të të gjitha pushteteve, që nga e kaluara, deri më sot.

Parlamenti Evropian miraton direktivën që mbrohet gazetarët kundër padive SLAPP

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Juristja e së drejtës së medias, Flutura Kusari, ka njoftuar se Parlamenti Evropian (PE) ka miratuar direktivën që mbrohet gazetarët kundër Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Ajo ka thënë se kjo është një arritje historike. "Gazetarët, mediet dhe aktivistët do të jenë më të mbrojtur nga paditë e pabaza të cilat bëhen nga avokatët dhe paditësit e këqij me qëllim të frikësimit dhe dekurajimit të tyre. Jam jashtëzakonisht e lumtur që si anëtare e Grupit të Ekspertëve të Komisionit Evropian kam ndihmuar në draftimin e direktivës bashkë me dhjetëra ekspertë të tjerë. Puna e Grupit të Ekspertëve do të vazhdojë në zbatimin e direktivës në praktikë", ka thënë Flutura Kusari.

Çfarë është kjo direktivë dhe çfarë do të thotë për Kosovën?

Direktiva është ligj i Bashkimit Evropian i cili duhet të zbatohet

te shtetet anëtare dhe shtetet që aspirojnë t'i bashkohen BE-së. Direktiva parasheh disa masa, garanci procedurale dhe mjete juridike që do të ndihmojnë në mbrojtjen e gazetarëve dhe aktivistëve nga paditë SLAPP. Ky ligj duhet të transpozohet dhe transpozimi mund të bëhet: a) duke draftuar dhe aprovuar Ligj Kundër Padive SLAPP; dhe b) duke ndryshuar disa ligje për t'i akomoduar kërkesat e direktivës. Njëkohësisht, institucionet e tjera si Oda e Avokatëve, Odat Ekonomike etj. të gjitha mund të marrin masa në zbatim të kësaj direktive. Elementet kryesore të direktivës janë:

Refuzim i hershëm i padive të pabaza - direktiva ua mundëson shteteve anëtare që të rregullojnë ligjërisht refuzimin e hershëm të padive abuzive. Për shembull, nëse një biznesmen, një person që ushtron një funksion publik ose kushdo tjetër ushtron padi të pabazuar kundër gazetarëve, gjykatat do të kenë mundësi që ato padi t'i refuzojnë sa më herët në procedurë, duke mos pritur që të kalojnë dhjetë vjet.

Sigurimi i shpenzimit dhe



dëmet - gjykata do të ketë të drejtën që ta obligojë paditësin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe dëmet eventuale para fillimit të gjykimit.

Barra e provës - barrën për të provuar që padia është e bazuar - do ta bartë paditësi që ushtron padinë.

Shpenzimet e procedurës - paditësit që kanë ushtruar padi

abuzive do të obligohen që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale, përfshirë shpenzimet e avokatëve të të paditurve.

Dënime dhe masa të tjera: Do të jetë e mundshme që të shqiptohen dënime për të gjithë ata që ushtrorin padi abuzive apo sanksione tjera si publikimi i aktgjykimit ose kompensimi i dëmeve. "Për juristët dhe

gjykatësit këto duken vështirë të zbatueshme në kontekst vendor por njëjtë ka qenë situata me mbrojtjen e sinjalizuesve. Në një botë ideale, në Kosovë do të duhej që tashmë ZKM ose MD të fillonin përgatitjet për transpozimin e kësaj direktive siç kanë bërë disa shtetet por unë kam zero shpresa që ndokush ka me u marrë me këtë sport", ka thënë Kusari.

UP-ja inauguron laboratorin STEAM në Fakultetin e Edukimit për ta avancuar cilësinë e mësimdhënies

PRISHTINË, 27 SHKURT - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi dhe dekani i Fakultetit të Edukimit, Blerim Saqipi, kanë inauguruar laboratorin modern 'Edukimi për STEAM' në Fakultetin e Edukimit.

Ky laborator, i pari i këtij lloji për qëllime arsimore, do të shërbejë për përgatitjen e mësimdhënësve të rinj në drejtim të zhvillimit të kreativitetit në procesin mësimor përmes zbatimit të teknologjisë në mësim dhe integritimit lëndor.

Kjo nismë edhe reflekton transformimin nga modelet



tradicionale të mësimin drejt modeleve krijuese si domosdoshmëri e kohës.

Laboratori ka pajisje robotike, pajisje të procesimit të gjuhës natyrale, mikrokontrollues të

riprogramueshëm, aparaturë CNC, pajisje virtuale, printer 3D, syze të mençura, pajisje EEG, kompjuter për gjenerimin e materialeve të hapura mësimore etj.

Rektori Qerimi tha se nismat si kjo "janë në funksion të qasjes së universitetit për modernizim dhe avancim të praktikave, duke u përafuar me universitetet modele në Evropë".

Përmes këtij laborator studentët do ta kenë mundësinë ta zhvillojnë shkathhtësinë e dizajnit të aktiviteteve mësimore që synojnë kultivimin e mendimit kritik përmes

integritimit të shkencës, teknologjisë, inxhinierisë, artit dhe matematikës në procesin mësimor.

Studentët, pra mësimdhënësit e ardhshëm, përmes përvijës në këtë laborator, do ta mësojnë qytetarinë digjitale, zbatojnë mjetet e prezantimit, shkëmbejnë tregime digjitale, dizajnojnë sfida të ndryshme robotike dhe prezantojnë prototipa të gjeneruara nga idetë e tyre. Pra, mësimdhënësit e ardhshëm do të jenë të përgatitur për të zbatuar mësimdhënie moderne, të orientuar në nxënësin dhe në forma atraktive.

Sveçla takon Hetemin, e njofton për angazhimin serioz të policisë në sjelljen e të dyshuarve për krime lufte para drejtësisë

PRISHTINË, 27 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Luftës, major Bashkim Spahiu, ka pritur të martën në takim drejtorin ekzekutiv të Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, Atdhe Hetemi. Me këtë rast, ministri Sveçla i uroi Hetemini detyrën e drejtorit të këtij Instituti të rëndësishëm për Republikën e Kosovës. Bashkëpunimi ndërinstytucional,

veçanërisht në mes të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Luftës dhe Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, kontribuon në evidentimin e të gjitha dëshmive të krimeve të kryera nga Serbia gjatë luftës në Kosovë dhe ndihmon në sjelljen e të gjithë kryesve para drejtësisë.

Ministri Sveçla e njoftoi drejtorin Hetemi mbi angazhimin serioz dhe të suksesshëm të Policisë së Kosovës në sjelljen e të

dyshuarve për krime lufte para drejtësisë dhe theksoi përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë mes dy institucioneve.

Hapja e Institutit dhe angazhimi i të gjithë aktorëve në fuqizimin e tij do të ndihmojë në ruajtjen e kujtesës kolektive, në adresimin institucional të gjenocidit të kryer nga Serbia në Kosovë dhe në drejtësi për të gjitha viktimat që i mungojnë shoqërisë dhe vendit tonë.



Dështimet me borxhin shtetëror të Kosovës 2021-2023



Shkruan: Avdullah HOTI

1. Asnjëri nga tre indikatorët kryesorë të borxhit shtetëror nuk është përmirësuar gjatë qeverisjes aktuale. Për korrektësi, krahasimet duhet të bëhen mes vitit të para pandemisë 2019 dhe vitit 2023: Borxhi shtetëror si përqindje e PBB-së: 17.63% në 2019 dhe 17.19% në 2023; Koha mesatare deri në maturim të borxhit: 5.29 vite në 2019 dhe 5.72

vite në 2023; Norma mesatare e interesit: 2.16% në 2019 dhe 2.44% në 2023.

2. Disbursimi i mjeteve nga marrëveshjet e borxhit gjatë viteve 2021-2023 ka qenë shumë jo efektiv. Vetëm gjatë vitit 2023, janë ratifikuar 8 marrëveshje në vlerë 288 milionë euro, prej të cilave 5 nuk janë as efektive ende. Vonesat në disbursim kanë ekzistuar edhe në të kaluarën, por në këtë mandat ka përkeqësuar.

3. Si parim, borxhi shtetëror merret për projekte kapitale që përdoren për dekada dhe kthehet nga përfitimet që vijnë nga shfrytëzimi i atyre projekte. Por qeveria aktuale, pa pasur asnjë krizë buxhetore, ka marrë borxh për skema sociale dhe për shkrimin e ligjeve. Kjo është në

kundërshtim me parimet e financave publike. Kjo tregon mungesën e strategjisë kombëtare që përcakton dy çështjet kryesore të borxhit shtetëror: (i) kur merret borxhi shtetëror dhe në çfarë shume dhe (ii) cilat janë projektet që financohen me borxh shtetëror.

Për informim të publikut: në Qeverinë Mustafa ishte themeluar Komiteti i Investimeve, që bashkë-kryesohej nga Ministri i Financave, i cili shqyrtonte kërkesat e ministrive dhe komunave për financim të projekteve përmes borxhit. Nëse projekti miratohej, Ministria e Financave merrte përsipër gjetjen e financimit më të përshtatshëm.

4. Gjatë vitit 2023, janë anuluar 5 nga 11 ankandet e letrave me vlerë

për huazim në tregun e brendshëm. Ky është sinjal i keq për tregun e brendshëm financiar, sepse krijon pasiguri dhe pamundëson planifikimet adekuate të portfoliove kreditore të bankave komerciale për ekonominë dhe familjet.

5. Vlerësimi kreditor shtetëror i Kosovës do të duhej të ishte kryer gjatë këtij mandati. Ai as nuk ka filluar. Ky vlerësim kryhet nga agjenci ndërkombëtare të vlerësimit dhe ka për qëllim të përcaktojë gjasat që një vend të mos paguajë borxhet. Ky vlerësim i hap Kosovës mundësinë për qasje në fondet e jashtme nga më të ndryshmet, përfshirë investimet e jashtme. Ky lloj vlerësimi është i rëndësishëm edhe për bankat komerciale për

qasje në fonde të jashtme më të favorshme për kreditin e ekonomisë dhe familjeve në Kosovë. Në mungesë të këtij vlerësimi, normat e interesit në Kosovë janë mesatarisht më të larta, që nënkupton se koston e mospunës së qeverisë për të kryer vlerësimin kreditor shtetëror po e paguajnë bizneset dhe qytetarët e Kosovës.

Për informim të publikut: në mandatin tim si Ministër i Financave në Qeverinë Mustafa, kemi diskutuar me akterët relevantë për kryerjen e këtij vlerësimi më 2017 apo 2018. Ajo qeveri u rrëzuar dhe vlerësimi nuk u krye. Gjatë mandatit të qeverisë aktuale, as nuk është menduar në këtë drejtim.

Kontratrat me negocim në MMPHI, opozita me akuza për ministrin Liburn Aliu



PRISHTINË, 27 SHKURT - Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, të mbajtur të martën, kryesuar nga kryetarja Hykmete Bajrami, pikë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i raportit të auditimit të performancës Prokurimet e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në

vitin 2021, mirëpo për shkak të mospranisë së ministrit të MMPHI-s, Liburn Aliu në Komision, u propozua që ky raport të procedohet në seancë plenare për shqyrtim. Megjithatë, anëtarë të Komisionit patën diskutime të shumta rreth raportit, akuza e kundërakuza ndaj kësaj ministrie.

Kryetarja e Komisionit, Hykmete Bajrami, sqaroi se ministri Aliu

disa herë e ka shtyrë këtë takim ndërkaq, sipas saj, sot ai sërish nuk është prezent me arsyetimin se ka udhëtuar jashtë shtetit. Me këtë rast, ajo propozoi që raporti të procedohet për shqyrtim direkt në seancën plenare. Edhe Hajdar Beqa, në cilësinë e deputetit raportues, tha se janë pajtuar që në mungesë të ministrit raporti të mos shqyrtohet në Komision, por të

procedohet për seancë.

Pas shterimit të diskutimit, propozimi që raporti të dërgohet në seancë për shqyrtim, me nëntë vota për, u përkrah nga Komisioni.

Më tutje, Komisioni shqyrtoi edhe raportin e auditimit të PVF-ve të Postës së Kosovës sh.a për vitin 2022. Të ftuar për t'i dhënë sqarimet e nevojshme ishin kryetarja e bordit, anëtarë të

bordit, si dhe kryeshefja ekzekutive e Postës.

Pasi anëtarja e Komisionit, Mirlinda Tishukaj Sadiku, shpallosi raportin në cilësinë e deputetes raportuese, duke sqaruar se është me opinion të pamodifikur dhe pasi ajo paraqiti në detaje gjetjet, përfaqësues të Postës dhanë përgjigje në të gjitha çështjet që u ngritën nga Komisioni.

Ministri Peci mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar Bujqësor në Paris

Prishtinë, 27 shkurt - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, me ftesë të autoriteteve franceze, ka marrë pjesë në edicionin e 60-të të Panairit Ndërkombëtar Bujqësor të Parisit (Salon International de l'Agriculture - SIA) në Paris - Porte de Versailles.

Në kuadër të kësaj vizite, ministri Peci ka marrë pjesë edhe në diskutimin ministror

që në fokus kishte temën "Ndryshimet klimatike dhe kushtet sanitare për blegtorinë". "Në diskutimin ministror, i cili është organizuar gjatë kësaj vizite, potencova rolin dhe ndikimin e faktorëve klimatikë në sektorin e blegtorisë si dhe përpjekjet dhe idetë bashkëpunuese për t'i adresuar sfidat brenda këtij sektori", ka thënë ministri

Peci.

Krahas pjesëmarrjes në panair dhe diskutimit ministror, ministri Peci ka vizituar edhe Ekspozitën Ndërkombëtare Bujqësore, e cila shërbeu si një platformë për të eksploruar bashkëpunime të mundshme, për t'i ndarë praktikatat më të mira, si dhe për ta nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e bujqësisë.



Historia e fisit Shala

(Pjesë nga vepra *Fiset shqiptare: Historia, shoqëria dhe kultura*, fq. 181-189)

Nga: Robert ELSIE

Pozita e territorit të fisit

Trojet fisnore të Shalës gjenden në zonën e Dukagjinit në veri të lumit Drin, në Qarkun e tanishëm të Shkodrës në veri të Shqipërisë. Shaljanët jetojnë në pjesën më të lartë të luginës së lumit Shalë, rreth fshatit Theth, ku mbaron lugina, dhe është i rrethuar me bjeshkë të larta në të gjitha anët. Shala kufizohet, sipas rajonit tradicionale të fisit, në Perëndim me Bogën, Shkrelin, dhe Planin përtej maleve, në Veri me Kelmendin matanë maleve, në lindje me Krasniqen dhe Nikajn përtej maleve dhe në jug me Shoshin. Ngulimet kryesore të Shalës janë: Abat, Bregluma, Gimaj, Lekaj, Lotaj, Nderlysa, Nënnavriq, Pecaj, Thethin dhe Vuksanaj.

Popullata

Emri Shala haset në gjuhën italiane në raportin kishtar të të Bonaventura di Palakolo nga Verçelli Piemonte në vitin 1634. Ai e quante këtë rajon Sciala. Në raportin e tij kishtar, të vitit 1671, vizitori papnor në Shqipëri, Pjetro Stefano Gasparini, e përdori fjalën Sala dhe shënoi: *Në këtë anë të malit Agri, në fund të Pulatit të Epërm, gjendet fshati i Shalës, që përbëhet nga 32 shtëpi dhe 20 frymë. Ata janë të fortë dhe të armatosur, si me kushtet fizike ashtu edhe me pozitën e tyre janë tërësisht të pavarur. Ata i sulmojnë pareshtur rajonet fqinje turke dhe pothuajse, gjithmonë kthehen si ngadhënjës.*

Në hartën e vitit 1688, të hartografit venedikas, Francesco Maria Coronelli, rajoni quhej Scialia. Gjithashtu figuron dhe si "Scialia" në vitin 1821, në hartën e diplomatit francez Hugues Pouqueville. Thuhet se ky term ka të bëjë me fjalën shqipe shalë, shalësinë, që do të thotë "tokë jopjellore dhe e thatë". Por, ky shpjegim nuk është aq bindës nga pikëpamja etimologjike, sepse Shala është një ndër vendet e pakta në malet e veriut që është e pjellore dhe nuk është e thatë. Shala është një fis që përbëhet nga një bashkësi që është e vetëdijshme për lidhjet e përbashkëta të gjakut, të historisë dhe të stërgjyshit.

Shala ka lidhje të ngushta me fisin e Shoshit. Të dy fiset janë kryesisht katolike dhe nuk kanë lejuar që të vendoset asnjë mysliman në luginë. Mbrojtësi i shenjtë i Shalës është Shën Gjoni, Evangjelisti, festa e të cilit kremtohet më 27 dhjetor. Megjithatë, siç ishte edhe rasti me fisin Nikaj, shumë pjesëtarë të fisit u kanë dhënë fëmijëve emra

myslimanë. Famullia katolike e Shalës është themeluar më 1763, ndonëse disa herë është braktisur gjatë historisë. Fisi Theth është bërë famulli e pavarur më 1892.

Shala e kremton edhe festën e Shën Mikelit, më 29 shtator, me prerjen dhe pjekjen e një dashi në hell. Para darkës, në vigjilje të festës së Shën Mikelit, në meshë ndizet një kandil dhe pas lutjeve shtrohet darka për nder të të shenjtit. Dikush nga familja duhet të bëjë roje tërë natën deri të nesërmen, për të siguruar që kandili të mos shuhet.

Nëse shuhet kandili, atëherë fati i lig do ta nullojë tërë familjen. Në *Informata të shkurtra për fiset e Shqipërisë së veriut, veçanërisht të Malësisë së pavarur*, të botuar më 1841, Nikollai, Princi i Vasojeviqëve, pohon se Shala ka një popullatë prej 4 000 banorësh, prej të cilëve 1 000 janë burra të armatosur. Hajsint Hekardi, në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë, raportonte se Shala kishte 275 shtëpi dhe 2 500 banorë. Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, thuhet se kjo trevë kishte 3 000 banorë.

Inxhinieri austriak, Karl Shtainmetc, i cili në gushtin e vitit 1903, i ka bërë vizitë rajonit të Shalës, ka lënë këtë vërejtje:

Shala është fisi më i fortë dhe më i njohur në Malësinë katolike. Përbëhet nga 500 shtëpi dhe afro 4500 frymë. Anëtarët e këtij fisi u përmbahen me një saktësi të madhe gjakderdhjes dhe tokave të vjetra. Dëshmia më e mirë për këtë janë ndërtesat e shembura të cilat i pashë derisa po kaloja rrugën nëpër këtë territor. Ky fis i ka lidhjet e ngushta me fisin e Shoshit, i cili jeton në pjesën jugore të luginës. Në tërë këtë luginë ka tre misionarë: njëri është në Abat, tjetri në Shosh dhe i fundit, që nga viti i kaluar, në Theth. Bajraktari i Shalës jeton në Pecaj, në truallin e Abatit.

Në regjistrimin e parë më të besueshëm i bërë në Shqipëri në vitin 1918 nën administratën e Austro-Hungarezëve, statistikat e popullsisë të fisit Shalë janë: 431 shtëpi me gjithsej 2 512 banorë. Në këtë rajon përfshihen edhe vendosjet në rrethinat e Abatit, Lekajt, Lotajt, Nenmarviqit, Nicajt, Pecajt dhe Thethi. Pjesëtarët e fisit të Shalës janë të njohur si barinj, bujq dhe cuba. Lugina është e pasur me ujë dhe kullosa të mira. Misri është zakonisht ushqimi kryesor, ndërsa gruri përdoret për përdorim vendas.

Shumë familje të Shalës kanë mërguar në rajonin e Pejës, në Kosovën perëndimore. Fshati i Isniqit, afër Deçanit, thuhet se banohet tërësisht nga shaljanët. Johann Georg von Hahn, i cili në



vitin 1858 udhëtoi nëpër Kosovë, të cilën e quante Shqipëria Dardane, kishte vënë re gjithashtu praninë e shaljanëve në periferi të Vushtrrisë, në Kosovën Verilindore:

Shala përbën popullsinë kryesore të rajonit të Vuçiternës dhe ka lidhje me Shalën katolike të Alpeve të Shqipërisë në veri, të cilën e konsideron si fisin amë.

Tani, në Kosovë, pjesëtarët e fisit të Shalës janë të përqendruar kryesisht në rrethinat e Mitrovicës dhe të Trepçës, në rajonin kodrinor që i thonë Shala e Bajgorës. Bajgora është ngulimi më i madh i tyre, meqë ka 37 vendbanime. Ata ndahen në katër klane ose vllazni: Gima, Peci, Maleti (ka farefisni me fisin Lotaj në Shqipëri) dhe Lopçi. Po kështu ka një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të fisit të Shalës në Isniq, të Lluka e Epërme dhe në Strellcin e Ulët afër Deçanit, në Ujmirë në lindje të Klinës, në Kopiliqin e Epërm në Drenicë, në Rakosh dhe Çitak në Podgor, dhe në disa fshatra të tjerë të luginës së epërme të Lepencit. Ç'është e vërteta, në numra më të vegjël, ata janë të pranishëm në mbarë Kosovën. Shumica e tyre e kanë ruajtur ndjenjën e përkatësisë fisnore.

Legjendat për fisin, stërgjyshërit dhe historia

Stërgjyshi legjendar i fisit të Shalës quhej Zog Diti, i biri i Dit Murrut dhe nipi i Murr Detit, i njohur po ashtu si Murr Dedi. Vëllai i Zog Diti, Mark Diti, ishte stërgjyshi i fisit të afërm të Shoshit, ndërsa vëllai i tij, Mir Diti, konsiderohej si i pari i fisit të Mirditës.

Sipas një tradite tjetër orale, të ngjashme me këtë, stërgjyshi i parë i Shalës quhej Nik Gjeku, i biri i Gjek Murrësit dhe nipi i Murr Dedit. Nik Gjeku pati katër djem: Pec Nika, Lot Nika, Lek Nika, dhe Ded Nika. Tre të parët themeluan ngulimet në Pecaj, Lotaj dhe Lekaj. Pasardhësit e Pec Nikës, më

vonë, themeluan disa vendbanime me emrin pak të ndryshuar, Nicaj.

Mirëpo, ndonëse kjo traditë nuk është aq e njohur, tradita orale e përshkruan Shalën me prejardhje nga një individ i quajtur Bal Shiroka.

Së bashku me fqinjin Shoshi, Shala ka pasur marrëdhënie të ngushta historike me Mirditën. Kështu, duket se ata kanë mbërritur deri në Luginën e Shalës nga jugu. Edith Durhami mendon se arritja e tyre në luginën e Shalës së Epërme është bërë më 1430. Sa për marrëdhëniet me Mirditën, Baron Nopça ka cekur se, në vitet e para të shekullit të njëzet, shumë më parë se kjo kohë, shaljanët ende mbanin dallama, që është një lloj përparëseje që arrin deri në gjunjë dhe është veshje karakteristike e fiseve të Mirditës. Në shekullin e tetëmbëdhjetë, shaljanët jetonin në shpella, duke i shpërfillur obligimet fetare dhe nuk punonin arat. Ata, padyshim ishin ndër fiset më të varfra të veriut, por njëherësh edhe mbrojtësit më të fuqishëm të dokeve të vjetra. Pikërisht këtu është zbatuar Kanuni i Lek Dukagjinit.

Dijetarja ruse, Julia Vladimirovna Ivanova (1922 – 2006), e cila në vitin 1956 dhe 1958 bëri disa kërkime shkencore në Shqipërinë e veriut, ia doli të mbledhë disa informata interesante mbi historinë e hershme të Shalës:

Në fund të shekullit të katërmëdhjetë, u bënë dyndjet e popullatës në malin Pashtrik, rajon ky afër Prizrenit. Një pjesë e popullatës shkoi në pjesën veriore të rrafshnaltës së Dukagjinit (Metohija). Një grup tjetër, duke përfshirë familjen e Murr Detit, shkoi dhe u vendos në malet e Pukës, në anën e majtë të lumit Drin. Ky rajon, gjithashtu është i njohur si Dukagjini i Vjetër. Këtu, në shekullin e pesëmbëdhjetë ose të shtatëmbëdhjetë, ndodhi një shpërngulje tjetër. Një pjesë e

popullatës u shpërngul mbi Qafën e Lokut dhe u vendos në rajonin që sot quhet Mirdita. Një pjesë tjetër e popullatës (të Shalës) u shpërngul dhe u vendos në brigjet juglindore të liqenit të Shkodrës dhe prej aty vazhdoi shpërnguljen drejt veriut, deri në luginën e Shalës. Kur arritën atje, ata gjetën popullatën vendase që quhej Mavriqi. [Morinasit – sipas një shkrimi të Nikoll Kimzës në vitin 1937, botuar në revistën Hylli i Dritës e të quajtur Hetime mbi vjetërsin e rrjedhën e Derës Gjomarkaj e të Mirditës, fisi Morina quhej edhe Marin – ishin fis në kuptimin klasik, pra një komunitet që është i vetëdijshëm për lidhjet e përbashkëta të gjakut dhe për historinë e përbashkët që arrin deri te një paraardhës i përbashkët mashkull dhe, sipas traditës gojore, ata duket se kanë një origjinë të përbashkët me fiset tjera si mirditorët, fisi Shala dhe me rajonin e Shoshit të cilët po ashtu e gjurmojnë origjinën e tyre në Malin e Pashtrikut në kufirin Kosovë-Shqipëri, jo shumë larg territorit të Morinës – shën. i Telegrafit.]

Shala përbëhet prej katër bajraqeve: Thethi, Pecaj, Lothaj dhe Lekaj; tre bajraqet ishin ndarë rreth vitit 1530. Te tjerët e ndajnë Shalën në tre bajraqe: vet Shala në lindje të bregut të lumit Leshnica, Gimaj dhe Thethi: këto dy fise të fundit nganjëherë konsiderohen si fise të pavarura. Edith Durhami, bie fjala, shkruan se bajraku i Thethit përbëhet prej 180 shtëpive. Edhe bajraku i Gimajt, zakonisht, konsiderohej si pjesë e Shalës, por herë pas herë e konsideronte veten te pavarur.

Shaljanët njihen në mesin e fiseve malësore për dinakëri dhe dredhi, ashtu si thotë fjala popullore:

Menja e Gashit, syni i Krasniqes, inati i Berishës, trimnia e Kelmenit, dredhia e Shaljanit, gjarpnia e Thaçit. /Telegrafi

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Federata e Golfit e Kosovës pranon aplikacionin zyrtar nga Federata Botërore e Golfit

Prishtinë, 27 shkurt - Federata e Golfit e Kosovës ka njoftuar se ka pranuar aplikacionin zyrtar nga Federata Botërore e Golfit. Me këtë rast, FGK-ja do

të bëhet anëtarja e re e familjes botërore në botën e golfit. "Federata e Golfit e Kosovës ka pranuar aplikacionin zyrtar nga

Federata Botërore e Golfit dhe pritet të bëhet anëtarja më e re e familjes së madhe botërore të Golfit!", thuhet në njoftim. "Urime gjithë lojtarëve dhe

anëtarëve të Kosovës!". Përndryshe, Federata e Golfit e Kosovës është themeluar zyrtarisht më 17 tetor të vitit 2018.



Kosova, fituese e turneut 'Turkish Women's Cup'

ALANYA, 27 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave për të dytin vit radhazi ka triumfuar në turneun ndërkombëtar "Turkish Women's Cup" që u mbajt në Alanya. Pas fitoreve ndaj Hong Kongut dhe Estonisë, "Dardanët" të martën në ndeshjen e fundit dhe përcaktuese për vendin e parë e kanë mundur Indinë me rezultat 1-0. Ndeshja ishte mjaft interesante. Të dyja ekipet shfaqën dëshirë për fitore dhe për t'iu gëzuar trofeut. Megjithatë, ishin "Dardanët" ato që në fund u shpërblyen me fitore për këmbëngulësinë e tyre, teksa në minutën e 3-të të kohës

shtesë Erëleta Memeti bëri një driblim të shkëlqyeshëm në zonën e Indisë dhe me gjuajtje të saktë dërgoi topin në rrjetë, duke e vulosur kësaj fitore e Kosovës. Dardanët kanë shfaqur formë të jashtëzakonshme gjatë gjithë turneut nën drejtimin e përzgjedhëses Anneli Andersen, duke vazhduar serinë pa humbje edhe këtë vit. "Kemi pasur një turne të shkëlqyeshëm. Kemi luajtur tri ndeshje dhe jemi përballuar me kundërshtarë shumë të mirë në të gjitha ndeshjet. Turneu përfundoi sot me ndeshjen më të vështirë ku u përballëm me Indinë. Ne kemi praktikuar shumë gjëra, ndonëse



jo shumë në fushë për shkak se ndeshjet ishin afër njëra-tjetres, megjithatë nëpër takime të ekipit

kemi punuar në detaje, duke përfshirë edhe taktikat tona. Pra, kemi bërë punë të madhe së

bashku, prandaj jam shumë e lumtur me gjithçka", ka thënë Andersen. "Sigurisht, është një bonus nëse fiton ndeshje ndërkombëtare, pasi ato tashmë janë bërë të vështira për t'u arritur, pasi futbollit i vajzave është përmirësuar kudo. Ne tani po presim me padurim shortin për ciklin e ardhshëm kualifikues, që do të tërhiqet më 5 mars. Tani për tani nuk e dimë se kë do të kemi kundërshtarë, por sigurisht se do të kemi kundërshtarë të fortë dhe do të udhëtojmë shumë në të gjithë Evropën. Prandaj, duhet të përmirësohemi në çdo gjë, nëse duam të kemi sukses", ka theksuar Andersen.

Khaka: Jam shqiptar me babë e me babagjysh

CYRIH, 27 SHKURT - Granit Khaka është një prej ambasadorëve më të mirë shqiptarë në botë. Ndonëse nuk merret me politikë, por i takon botës së sportit, ylli i

Bayer Leverkusenit i ka bërë shqiptarët shpesh të mburren me paraqitjet e tij dhe me shenjat që u ka dhënë përmes gjesteve, duke mos e harruar asnjëherë

prejardhjen e tij. Ish-futbollisti i Borussia Monchengladbachut dhe Arsenalit, e ka konfirmuar këtë edhe në një video të publikuar në Facebook nga babai i tij, Ragipi. Mesfushori kualitativ në një video direkte në "Tik Tok" deklaroi me shumë mburrje që është shqiptar, me babë e babagjysh. "Gjakun tim nuk e harroj kurrë", thotë përfaqësuesi zviceran, i cili ndërkohë e falënderon Zvicrën për gjithçka që i ka dhënë dhe mundësinë për të arritur deri këtu. "Jam shqiptar me babë, me babagjysh e me gjak", shton 31-vjeçari, i cili po shkëlqen në fanellën e Leverkusenit pas rikthimit të tij në Bundesligë. Khaka e ka formuar shqiponjën dykrenore pasi kishte shënuar gol ndaj Serbisë në Botërorin e Rusisë, ndërsa ishte protagonist në përballje me serbët edhe në Botërorin e fundit. Pa dyshim, ai është krenari e Kosovës, por edhe e krejt shqiptarëve anembanë botës.



Bilanci i Kosovës për ndeshjet e shkurtit ishte një fitore e një humbje



Prishtinë, 27 shkurt - "Dardanët" mundën Irlandën 83:76 dhe pësuan nga Azerbajxhani 88:77. Edhe Azerbajxhani ka një fitore e një humbje, kurse lidere është Zvicra me dy fitore (ndaj Azerbajxhanit dhe Irlandës), kurse e fundit është Irlanda me dy humbje. Ndeshjet e ardhshme

për Kosovën do të jenë në udhëtim, kundër Zvicrës dhe Irlandës në muajin nëntor, derisa kampanjën për Rrethin e Parë Parakualifikues Evropian për Kupën e Botës 2027 e mbyll në muajin shkurt të vitit të ardhshëm ndaj Azerbajxhanit dhe Zvicrës.

Kosova U18 grumbullohet për herë të parë për këtë vit

Prishtinë, 27 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës U18 është grumbulluar për herë të parë këtë vit, përkatësisht për herë të katërt që nga krijimi i saj. Nën drejtimin e

përzgjedhësit Sami Sermahaj dhe stafit të tij Alban Dragusha, Sheremet Isufi, Erdin Hashani dhe Flamur Neziri, 34 lojtarët e grumbulluar do të stërvitin

për tre ditë rresht në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Përzgjedhësi Sermahaj e ka vlerësuar pozitiv faktin që federata ka vendosur ta ndjekë hapin e

vendeve të zhvilluara për krijimin edhe të përfaqësuesve U16, U18 dhe U20. Pjesë e këtij grumbullimi janë edhe tre lojtarë që luajnë në klubet evropiane.



Aguero planifikon t'i rikthehet futbollit

BARCELONË, 27 SHKURT - Në nëntor të vitit 2021 Sergio Aguero u detyrua të dilte në pension të parakohshëm në moshën 33-vjeçare. Pasi iu bashkua Barcelonës nga Manchester City pak muaj më parë, sulmuesit argjentinas iu desh t'i varte

këpucët pasi u zbulua se kishte një problem me zemrën. Megjithatë, pak më shumë se dy vjet nga ai moment, Aguero mund të vendosë për rikthim të papritur në futboll. Gazeta spanjolle "Mundo Deportivo" raporton se argjentinasit i është

thënë nga një kardiolog se ka mundësi që ai të dalë nga pensioni dhe pas kësaj, ai u pa në një ndeshje midis Independiente dhe Racing Club në Argjentinë. Mediet nga Amerika e Jugut raportojnë se Aguero ka një opsion për t'u rikthyer në futboll

me Independiente, që tani menaxhohet nga ish-shoku i tij i skuadrës dhe miku i mirë Carlos Tevez. Megjithatë, në këtë fazë ende nuk është e qartë nëse ish-sulmuesi i Barcelonës do ta marrë vendimin për t'u rikthyer në futboll.



Veliaj pret kampionin dhe nënkampionin e Evropës në mundje: Do të mbështesim skuadrën tonë olimpike

TIRANË, 27 SHKURT - Bashkia e Tiranës do të marrë disa vendime për ta mbështetur me anë të granteve skuadrën olimpikë të Shqipërisë në prag të lojërave që do të mbahen në Paris gjatë këtij viti. Kështu deklaroi kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, në takim me përfaqësues të skuadrës olimpikë, ku ishin të pranishëm Zelimkhan Abakarov dhe Islam Dudaev, të cilët disa ditë më parë sollën në Shqipëri titujt e kampionit dhe nënkampionit të Evropës në mundje. "Është një kënaqësi e jashtëzakonshme ta prisja skuadrën tonë të mundjes, Zelimkhanin dhe Islamin, në një Tiranë dhe Shqipëri që ka nevojë për modele pozitive si ata. Ne si Bashki do të marrim disa vendime: së pari, do të japim një grant nëpërmjet klubeve tona, edhe për Komitetin Olimpik Shqiptar. Puna që po bën Fideli dhe e gjithë skuadra, që po përgatitet për të shkuar në Paris, nderon Shqipërinë. Këtë herë kemi shumë shanse. Sigurisht Tokyo ishte një përvojë e jashtëzakonshme, por tani e kemi ngritur nivelin. Kam shumë besim se do të bëjmë një performancë edhe më dinjitoze në Paris", ka thënë Veliaj.



Ai theksoi se Tirana do të vazhdojë ta ruajë mbështetjen për sportin dhe sjelljen sportive me të njëjtin standard si gjatë vitit që lamë pas, kur mbajti titullin "Qyteti Evropian i Sportit". Veliaj nënvizoi se kryeqyteti do ta mirëpresë edhe Kongresin Botëror të Mundjes si dhe dy kampionatet U23 dhe për të rritur. "Ne duam jo vetëm të japim një grant për Komitetin Olimpik, për të pasur një prezantim sa më dinjitoz, por duam të vazhdojmë edhe këtë vit të sillemi me të njëjtin standard, për ta kthyer në rutinë, me ose pa titullin Qyteti Evropian i Sportit, sjelljen sportive dhe mbështetjen

për sportin. Mezi pres të mirëpresim në Tiranë Kongresin Botëror të Mundjes dhe të mbështesim edhe dy kampionatet U23 dhe për të rritur. Fakti që sot kemi në mundje edhe vajzat, që po trajnohen dhe po afrohen te sporti, pavarësisht se në dukje është një sport luftarak; fakti që sot përveç dy çunave janë 22 sportistë të tjerë që trajtohen, do të thotë se të paktën në Tiranë skuadrën tonë të mundjes, që është edhe skuadra jonë olimpikë, e kemi sjellë në një nivel që nuk i lë asgjë mangët çdo niveli tjetër evropian dhe botëror", ka shtuar Veliaj.

Miami nuk i ndahet 'trenit' të pretendentëve, triumfojnë edhe Toronto dhe Brooklyn

SACRAMENTO, 27 SHKURT - Miami fitoi me rezultat 121-110 në fushën e Sacramentos, duke qëndruar në grupin e ekipeve pretendente në Konferencën e Lindjes. Adebayo me 28 pikë dhe Jaquez me 26 pikë bënë dallimin për Miamin. Toronto, falë një loje të mirë kolektive, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (përfshi titullarët), mundi me rezultat 130-122 Indianan jashtë fushës. Mathurin e Siakam realizuan 61



pikë së bashku për Indianan, por që mbetën për statistikë. Jashtë fushës fiton edhe Brooklyn, që mundi Memphisin (111-86), sfidë ku dallimin në parket e bëri

Schroder me 18 pikë. Sukses në sekondat e fundit për New York, që falë 35 pikëve e 12 asistimeve të Brunsonit mundi 113-111 Detroitin.

REZULTATET

Indiana - Toronto	122-130
New York - Detroit	113-111
Memphis - Brooklyn	86-111
Sacramento - Miami	110-121

Guardiola: Fantastike puna që po bën Alonso

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka vlerësuar lart punën që po bën Xabi Alonso me Bayer Leverkusenin. Guardiola theksoi se tani është pjesa më e rëndësishme e sezonit dhe

nuk duhet nënvlerësuar Bayern Munichu. "Uau! Puna që ai po bën, fantastike", u shpreh fillimisht Guardiola. "E vetmja skuadër e pamposhtur, që lufton me Bayernin. Tani është pjesa më e rëndësishme

e sezonit. Ata nuk mund ta fitojnë Bundesligën, mund ta humbin atë... sepse të gjithë mendojnë që u krye ajo punë", ka deklaruar Alonso. Leverkuseni është në vend të parë në Bundesliga me 61 pikë

të grumbulluara, me tetë më shumë se Bayern Munichu që është në pozitën e dytë. Alonso mund ta shkruajë historinë me "Farmaceutikët", pasi ky klub nuk e ka fituar asnjëherë më parë

Bundesligan. Përndryshe, Alonso kishte zbuluar vite më parë se ishte larguar nga Real Madridi në vitin 2014 për në Bayern pasi kishte dëshirë të luante nën drejtimin e Pep Guardiols.

SHKURT

Dalin në shitje biletat e miqësore Suedi - Shqipëri

Federata Shqiptare e Futbollit njofton të gjithë tifozët e Kombëtares se kanë dalë në shitje biletat e ndeshjes miqësore Suedi - Shqipëri, që do të luhet më 25 mars në stadiumin "Friends Arena" të Stokholmit në Suedi. Tifozët shqiptarë do të kenë në dispozicion 1 500 bileta në sektorët 117-118-119. Çmimi i biletës për këtë ndeshje miqësore do të jetë 100 krona suedeze. FShF-ja bën me dije se biletat e vlefshme për këtë ndeshje do të shiten online.

Dybala pasi shënoi tre gola ndaj Torinos: Dua të fitoj trofe

Paulo Dybala ishte heroi i Romës, në suksesin 3-2 ndaj Torinos. Sulmuesi argjentinas realizoi tre gola, duke udhëhequr ekipin drejt tri pikëve. Ai ka thënë se synon të fitoj trofe me skuadrën e Romës. "Unë gjithmonë dua të fitoj trofe. Është e qartë se rrugëtimi në Ligën e Evropës është ende i gjatë, por ne e dimë se cilat janë objektivat tona dhe punojmë çdo ditë për t'i arritur ato. Kur arrita këtu thashë se më dukej sikur kisha një jetë që isha këtu. Nuk e di se çfarë më pret në të ardhmen, por sigurisht që po e shijoj të tashmen", ka thënë Dybala, i cili po luan sezonin e dytë te Roma. Në këtë edicion ai ka shënuar 11 gola dhe ka asistuar 6 herë.

Tri klube të Premierë Ligës shprehin interesim për Inzaghin

Simone Inzaghi po e drejton në mënyrën më të mirë të mundshme dhe kjo ka bërë që shumë klube të Premierë Ligës të shprehin interesim për të angazhuar. "Tuttosport" raporton se fjala për klubet e interesuara për strategun italian janë Manchester United, Chelsea dhe Liverpooli. 47-vjeçari ka kontratë me Interin deri në qershor 2025 dhe fiton 5.5 milionë euro neto në sezon plus shtesa. Ofertat e Premierë Ligës mund të arrijnë rreth 8-9 milionë euro në vit, shifra që klubi i tij italian nuk ka gjasa t'i ofrojë.

Barcelona ia heq Alvesit statusin e legjendës së klubit

Dani Alves është përballur me probleme të mëdha kohët e fundit. Ish-ylli brazilian është akuzuar për abuzim seksual, ku gjykata e Barcelonës e ka dënuar me katër vjet e gjashtë muaj burgim. Alves, i cili konsiderohej si një nga mbrojtësit më të mirë që ka veshur fanellën e Barcelonës, tani ka pësuar goditje të mëdha dhe imazhi i tij është zbehur krejtësisht. Duke parë zhvillimet e tij, Barcelona ka vendosur t'i heqë Dani Alves statusin e tij si legjendë e klubit, një titull që iu dha 102 lojtarëve që kanë veshur fanellën e katalanasve që nga themelimi i klubit.



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Statisticienti i ri
Grada e pozitës:	shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	i Statistikës
Divizioni:	Statistikat Financiare
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave Financiare

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Zbaton programin e punës të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të Divizionit të Statistikave Financiare;
- Identifikon burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e statistikave të llogarive financiare;
- Avancon kornizën raportuese për mbledhjen e të dhënave nga sektorët e nevojshëm institucional me qëllim të integritetit të tyre në statistikat e llogarive financiare.
- Mbledhë të dhënat statistikore dhe i kontrollon ato; integron statistikat nga sektori financiar dhe jo-financier dhe përpilon statistikat e llogarive financiare në nivel vendi në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
